REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL BERAT
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr.______Prot. Berat, më____.____.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës –Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

Objekti i kontratës/marrveshjes kuadër: Objekti i kontratës/marrveshjes kuadër: "Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike dhe Barnash te deleguara, ndare ne 7 (shtate) Lote - *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj".*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
Produkte Farmaceutike -33600000-6
Kontenitore te ndryshem -44619000-2
VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 484,865.00 (katerqindetetedhjeteekatermijeeteteqindegjashtedhjeteepese) Lekë pa TVSH.

| Nr. | Sistemi | Principi Aktiv | Forme-doza | Njesia | Sasia e planifikuar per 12 muaj | Fondi Limit | Fondi Limit me germa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Loti 1 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Cisplatine | 50 mg | Flakon | 50 | 69,550.00 | gjashtedhjeteenentemijeepeseqindepesedhjete |
| Loti 2 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Dacarbasine | 100 mg | Flakon | 50 | 39,000.00 | tridhjeteenentemije |
| Loti 3 | Barna Antineoplastike dhe immunom | Folinic acid | 10 mg/ml - 5ml | Flakon/ Ampule | 100 | 43,022.00 | dyzeteetremijeenjezeteedy |


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | odulatore | | | | | | |
| Loti 4 | Gjaku dhe organet formuese te gjakut | Acenocoumarol | 4mg | tablete | 100 | 530.00 | peseqindetridhjete |
| Loti 5 | Sistemi muskolo-Skeletik | Dantrolene sodium | 20mg | flakon | 2 | 17,838.00 | shtatembedhjetemijeeteteqindetridhjetetete |

Loti 6 "Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike"(në zbatim të kontratës konçesionare të laboratorëve)

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër 273,025.00 (dyqindeshtatedhjeteetremijeenjezetetepese) Lekë pa TVSH.

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Volumi , permasat | Njesia | Sasia e pritshme per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 120ml | Cope | 60 |
| 2 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 500ml | Cope | 120 |
| 3 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 1000ml | Cope | 180 |
| 4 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 3000ml | Cope | 120 |
| 5 | Furce per marrje materiali cervikal per testim PAP-test | | Cope | 200 |
| 6 | Xhama Objekt mbajtes | Fund I zmeriluar | Cope | 3000 |
| 7 | Xhama Objekt mbulues | 24mm x 50mm | Cope | 3000 |
| 8 | Kontenitor i vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes per marrjen e biopsive likide te palces kurrizore, biopsive renale, te gjirit etj. | Rreth 60-90ml | Cope | 100 |


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

Loti 7 “Blerje Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test” (në zbatim të kontratës konçesionare të laboratorëve)

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër 41,900.00(dyzeteenjemijeenenteqind) Lekë pa TVSH.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test | | Cope | 200 |

Argumentim: Bazuar ne kontraten e koncesionarit te laboratoreve PPP te MSHMS-se me Nr. 1924/2 Prot. date 10.04.2019 protokolluar ketu me Nr. 3737/1 Prot. date 04.09.2019, mailin Nr.844 prot. date 04.03.2021 mbi zbatimin e kontrates se koncesionit te laboratoreve me specifikimet teknike te pershkruara ne shtojcen 6 te marreveshjes se nderveprimit, mail-in me Nr. 586 Prot. date 06.02.2023 ne kuader te pergatitjeve per fillimin e sherbimit te Anatomise- Patologjike te koncesionarit, Udhezimin Nr. 216 Prot. date 16.01.2023 protokolluar ketu me Nr. 271 Prot. date 18.01.2023, shkresen nga MSHMS Nr. 3309/7 Prot. date 11.10.2022 protokolluar ketu me Nr. 3956 Prot. date 12.10.2022, Urdherin Nr. 3826 Prot. date 03.10.2022 me Nr. 556 date 03.10.2022 “ Per sherbimin e Kemioterapise”, Urdherin Nr. 4272 Prot. date 03.11.2022 protokolluar ketu me Nr. 4311 Prot. date 07.11.2022, shkresen Nr. 3826/3 Prot. date 10.11.2022 protokolluar ketu me Nr. 4275/1 Prot. date 11.11.2022, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 843 Prot., datë 23.02.2023, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.4216 Prot. datë 01.11.2022 , kerkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.1619 Prot. datë 24.04.2023, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 4288 Prot. date 21.09.2023 për proceduren e hapur te thjeshtuar me objekt: “Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike dhe Barnash te deleguara, ndare ne 7 (shtate) Lote - *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”., me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej* 484,865.00 katerqindetetedhjeteekatermijeeteteqindegjashtedhjeteepese) Lekë pa TVSH, *bazuar ne nenet 34,35 te ligjit Nr. 162/2020 dhe nenin 76 pika c e VKM_RPP_285_19.05.2021.*

Argumentimi I fondit limit: Kërkesa e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 843 Prot., datë 23.02.2023, argumentimin e fondit limit me Nr. 1344 Prot., datë 30.03.2023, kërkesa e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.4216 Prot. datë 01.11.2022 me shkresen e përllogaritjes të fondit limit të miratuar nga komisioni I argumentimit te fondit limit me Nr. 4649 Prot, date 06.12.2022, kërkesa e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.1619 Prot. datë 24.04.2023, shkresen e përllogaritjes të fondit limit të miratuar nga komisioni I argumentimit te fondit limit me Nr.1688 Prot. datë 27.04.2023, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 4288 Prot. date 21.09.2023 shkresen e përllogaritjes të fondit limit të miratuar nga komisioni I argumentimit te fondit limit me Nr.4344 Prot. datë 22.09.2023 për proceduren e hapur te thjeshtuar me objekt: “Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike dhe Barnash te deleguara, ndare ne 7 (shtate) Lote - *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”., me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej* 484,865.00 katerqindetetedhjeteekatermijeeteteqindegjashtedhjeteepese) Lekë pa TVSH, *bazuar ne nenet 34,35 te ligjit Nr. 162/2020 dhe nenin 76 pika c e VKM_RPP_285_19.05.2021.*


Lagjia “Kushtrim”Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor *Spitali Rajonal Berat*ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Te njejta per Lotet 1, 2, 3, 4, 5.

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.


Lagjia “Kushtrim”Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, AutoritetiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

<u>b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;</u>

Argumentimi: Kjo shtojce <u>eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit</u> per proceduren e prokurimit te sipercituara.

<u>c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;</u>

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020"Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese Licencë e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave per njerez.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se:


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne piken 1 te nenit 28 te Ligjin nr. 105/2014 "Per barnat dhe Sherbimin Farmaceutik" ne te cilen eshte e percaktuar se: *Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin".*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**a)** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se *40%e vleres se fondit limit** te kontrates qe prokurohet.

*Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10..*

*Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur*.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,"Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar*; ne nenin 43 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" , si dhe nenin 47 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se.Vendosja e ketyre kritereve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbuashur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

*a)Deshmi nga operatori ekonomik per realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizime të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël 20% e vlerës sëpërllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratëndhe/ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te realizuara.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore*, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

<u>*Shënim*:*</u>*Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10.*
*Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021*

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që furnizimet e mallrave te mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

b)Për barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose çertificatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", si dhe ne piken 3 te nenit 3, ne piken 1 te nenit 1, ne nenin 17/1 dhe ne nenin 18 teLigjit nr.105/2014 "Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik". Nga sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken b) te kapacitetit tekinik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

<u>c)Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohetduhet:</u>

<u>- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Mbretëria e Bashkuar; /ose/</u>


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

- të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre,
/ ose/
- te jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: *Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë leshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail,web-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregetimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.*

Argumentimi*:* Ky kriter u vendos ne mbeshtetje të pikes 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, ”Per Prokurimin Publik”, si dhe ne nenin 12 dhe ne nenin 14 teLigjit nr.105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”. Kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken c) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

ç) Kerkohet Autorizim:

- Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohetAutorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar *(ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH)* nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje barnat e tyre. Autorizimi duhet te jete i vlefshem per te gjithe periudhen e kerkuar.

- Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohetAutorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar *(ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit)* nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje barnat e tyre. Autorizimi duhet te jete i vlefshem per te gjithe periudhen e kerkuar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne nenin 11 dhe me nenin 12 teLigjit nr. 105/2014 *“Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik” i ndryshuar.* Duke qene se per barnat e percaktuara tek pika b) e kapaciteti teknik behet fjale per tregtim te barna te autorizuara ne vendin tone, atehere dokumenti shoqerues qe e verteton kete fakt eshte pikerisht Autorizimi per Tregtim nga mbajtesi i MAH (Mbajtesi i Autorzimit per Tregtim). Per barnat e percaktuara tek pika c)ekapaciteti teknikbehet fjale per tregtim te barna te paautorizuara ne vendin tone, atehere dokumenti shoqerues qe kerkohet eshte Autorizimi per Tregtim nga mbajtesi i MAH (Mbajtesi i Autorzimit per Tregtim) ose Autorizim Prodhuesi nga i cili jane prodhuar barnat per te cilat nje operator ekonomik oferton. Ne kete rast Autorizimi i Prodhuesit eshte nga vendi prodhues qe e autorizon subjektin te tregtoje barnat objekt i kesaj procedure prokurimi.Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë AK me produktet e tij; Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues*(Per me teper ref.Vendim i KPP nr.353/2014).* Gjithashtu vendosja e ketij kriteri gjen mbeshtetje edhe tek pika 4, neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, *”Per Prokurimin Publik”* si dhe ne rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 *“Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit*


Lagjia “Kushtrim”Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*publik".* Per sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken ç) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

d) Deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) përbarin e ofertuar.
dh) Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesëAutodeklarate për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të Shtojces 5.

Argumentimi*:* Kriteri i vendosur në germën d) dhe dh) eshte vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik. Deklarata mbi origjinen e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) si dhe deklarata per plotësimin e afatit te skadences se mallit të ofruar, eshte kerkuar ne menyre qe me ane te saj do te behet krahasimi i ofertes, barnave që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

*Shenim për operatoret ekonomik:*

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet* e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[1]. Këto dokumente duhet të *paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
Te njejta per Lotet 6, 7.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, AutoritetiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.


Lagjia “Kushtrim”Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

*2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*

*1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*<u>a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;</u>*
*Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*
*<u>b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;</u>*
*Argumentimi: Kjo shtojce <u>eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit</u> per proceduren e prokurimit te sipercituara.*
*<u>c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;</u>*
*Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020"Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.".*

*Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*Sipas kritereve te pergjitheshme per kualifikim.*

*2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*

*2.2.1. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e vlerës sëfondit limit te lotit ose shumes se loteve për të cilat konkurron operatori.*

*Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10.*

*<u>Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur</u>.*
*Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,"Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vleres se perllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar.*

*Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.*

---

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

*2.3 Kapaciteti teknik:*

*2.3.1 Deshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se 20% te vleres së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*-Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ke shenohen datat shumat dhe sasite e mallrave te realizuara.*

*-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruara ne organet tatimore ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te realizuara.*

*Shënim*:Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10.*

*Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.*

*Argumentimi:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik",ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që furnizimet e mallrave te mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.*

*Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që furnizimet e mallrave te mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.*

*2.3.2. a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën ISO 9001:2015/ ose / ekuivalent mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", me objekt aktiviteti te certifikates per tregetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

*b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet kur nuk eshte prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet te paraqese autodeklarate qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte konform standarteve te cilesise ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ISO 13485:2016 mbi "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore", te vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.*

*AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.*

*Argumentimi: Ky kriter i percaktuar ne piken a) dhe b) eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se:*

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

*Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*2.3.3. Vetedeklarim se te gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) te jene te certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyera dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

*Argumentimi:Ky kriter i përcaktuar në pikën a) dhe b) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuar se:*

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

*Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik", rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".*

*2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.*

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

*Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku eshte e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti/enti kontraktor.*
*Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore "Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik".*
*2.3.5.Vetedeklarim i operatorit ekonomik lidhur me origjinen e mallit, ku te percaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.*

*Argumentimi: Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter eshte ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.*

*2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.*

*Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 2 " Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim." Si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", neni 40 pika 5 a) Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.*
*Argumentimi: Ky kriter eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*
*Paraqitja e katalogjeve per te gjithe artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se materialeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5.*

*2.3.8. Për të gjithë artikujt e ofertuar, duhet te paraqiten mostra deri ne ditën e hapjes se ofertave*

*Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sekretarise Zyres se protokoll-Arshives, Spitalit Rajonal Berat, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

*-"Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « ………. » dhe jo para dates se hapjes se ofertave.*

*-Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*-Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.*

*Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

*Bazuar si dhe ne Udhezimin Nr. 3 date 12.04.2022 me Nr. 2564 Prot. I APP-se mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga OE.*

*Paraqitja e mostrave per artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te materialeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5, dhe duke qene se ato kane nje natyre te vecante, per te bere te mundur vleresimin e tyre eshte i nevojshem testimi i tyre ne Sherbimi Laboratorit*

*Shenim për operatoret ekonomik:*

*Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[2]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- *Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.*


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

- *Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.*
- *Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.*

*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

"Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike dhe Barnash te deleguara, ndare ne 7 (shtate) Lote - *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj", me* Fond limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 484,865.00 (katerqindetetedhjeteekatermijeeteteqindegjashtedhjeteepese) Lekë pa TVSH.

| Nr. | Sistemi | Principi Aktiv | Forme-doza | Njesia | Sasia e planifikuar per 12 muaj | Fondi Limit | Fondi Limit me germa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Loti 1 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Cisplatine | 50 mg | Flakon | 50 | 69,550.00 | gjashtedhjeteenentemijeepeseqindepesedhjete |
| Loti 2 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Dacarbasine | 100 mg | Flakon | 50 | 39,000.00 | tridhjeteenentemije |
| Loti 3 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Folinic acid | 10 mg/ml - 5ml | Flakon/ Ampule | 100 | 43,022.00 | dyzeteetremijeenjezeteedy |
| Loti 4 | Gjaku dhe organet formuese te gjakut | Acenocoumarol | 4mg | tablete | 100 | 530.00 | peseqindetridhjete |


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Loti 5 | Sistemi muskolo-Skeletik | Dantrolene sodium | 20mg | flakon | 2 | 17,838.00 | shtatembedhjetemijeeteteqindetridhjetetete |

- Afati I skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.
- Formë – doza, njësia dhe volume për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese të jetë sipas specifikimeve teknike.
- Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emir I barit, formë - doza, kodi I barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. I serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/kutinë e ambalazhit të tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin "PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA".

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Loti 6 "Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike.

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër 273,025.00 (dyqindeshatedhjeteetremijeenjezetetepese) Lekë pa TVSH.

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Volumi , permasat | Njesia | Sasia e pritshme per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 120ml | Cope | 60 |
| 2 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 500ml | Cope | 120 |
| 3 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 1000ml | Cope | 180 |
| 4 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 3000ml | Cope | 120 |
| 5 | Furce per marrje materiali cervikal per testim PAP-test | | Cope | 200 |
| 6 | Xhama Objekt mbajtes | Fund I zmeriluar | Cope | 3000 |
| 7 | Xhama Objekt mbulues | 24mm x 50mm | Cope | 3000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8 | Kontenitor i vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes per marrjen e biopsive likide te palces kurrizore, biopsive renale, te gjirit etj. | Rreth 60-90ml | Cope | 100 |

- Afati I skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Loti 7 "Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test"

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër 41,900.00 (dyzetetenjemijeenenteqind) Lekë pa TVSH.

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Volumi , permasat | Njesia | Sasia e pritshme per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test | | Cope | 200 |

- Afati I skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi I kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

*Afati i lëvrimit të mallit do të jetë sipas kërkesave të Spitalit Rajonal Berat.*

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

| Nr. | Sistemi | Principi Aktiv | Forme-doza | Njesia | Sasia e planifikuar per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|---|
| Loti 1 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Cisplatine | 50 mg | Flakon | 50 |
| Loti 2 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Dacarbasine | 100 mg | Flakon | 50 |
| Loti 3 | Barna Antineoplastike dhe immunomodulatore | Folinic acid | 10 mg/ml - 5ml | Flakon/Ampule | 100 |
| Loti 4 | Gjaku dhe organet formuese te gjakut | Acenocoumarol | 4mg | tablete | 100 |
| Loti 5 | Sistemi muskolo-Skeletik | Dantrolene sodium | 20mg | flakon | 2 |

Loti 6 "Blerje materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike"(në zbatim të kontratës konçesionare të laboratorëve) me fond limit 273,025.00 (dyqindeshtatedhjeteetremijeenjezeteepese)

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Volumi , permasat | Njesia | Sasia e pritshme per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 120ml | Cope | 60 |
| 2 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 500ml | Cope | 120 |
| 3 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 1000ml | Cope | 180 |
| 4 | Kontenitor me formaline per biopsite | Vol. 3000ml | Cope | 120 |
| 5 | Furce per marrje materiali cervikal per testim PAP-test | | Cope | 200 |
| 6 | Xhama Objekt mbajtes | Fund I zmeriluar | Cope | 3000 |


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Xhama Objekt mbulues | 24mm x 50mm | Cope | 3000 |
| 8 | Kontenitor i vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes per marrjen e biopsive likide te palces kurrizore, biopsive renale, te gjirit etj. | Rreth 60-90ml | Cope | 100 |

Loti 7 “Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test
Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër 41,900.00 (dyzetetenjemijeenenteqind)Lekë pa TVSH.

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Volumi , permasat | Njesia | Sasia e pritshme per 12 muaj |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material cervikal per PAP-test | | Cope | 200 |

Per te gjitha Lotet:
Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE te shpallur fitues për secilin lot, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK-se.
Spitali Rajonal Berat do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontrate të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do te jene si me poshtë:

- 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Vendi i dorezimit te mallit do të bëhet prane Farmacise se Spitalit Rajonal Berat.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Argumentimi per sasite dhe specifikimet teknike jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes sasive dhe te specifikimeve teknike ne : kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 843 Prot., datë 23.02.2023, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.4216 Prot. datë 01.11.2022, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr.1619 Prot. datë 24.04.2023, kërkesen e miratuar me sasite e specifikimet teknike nga shërbimi I Farmacisë me Nr. 4288 Prot. date 21.09.2023 si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neneve 20 dhe 49 teLigjit nr. 105/2014 *“Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”.*
Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.


Lagjia “Kushtrim”Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për Mallin objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".
Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".
Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

NJESIA E PROKURIMIT

Armelin Çili | Aida Doko | Anesti Kushi

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ANILA KALA


Lagjia "Kushtrim"Berat,Albania Tel./Fax 00355 3234 237.e-mail spitaliberat@shendetesia.gov.al